

Cila është e vërteta për prejardhjen kombëtare të hulumtuesit Atanasije Uroshëviqit

Dr. Qazim Namani

Atanasije Uroshëviq, i lindur me 14 tetor të vitit 1898, në qytetin e Gjilanit, dhe ka vdekur në Beograd. Me datën 17 tetor të vitit 1992, vetëm 3 ditë pasi i mbushi plotë 94 vite jetë.

Në burimet serbe thuhet se: Atanasije Uroshëviq ishte një gjeograf, antropogjeograf dhe etnolog serbë, i cili ka dhënë një kontribut të madh, në studimin e të kaluarës në territorin e Kosovës.

Sipas burimeve serbe origjina e familjes së Atanasije Uroshëviqit, është nga Hoça e Madhe, por sipas rrëfimeve tjera thuhet se kjo familje ishte me origjinë nga qyteti i Prizrenit. Është e pa besueshme, kur Uroshëviq shkruan pikërisht për origjinën e familjeve dhe për vendbanimet në Kosovë, e të mos shkruante të vërtetën për origjinën e familjës së tij! Në burimet serbe po ashtu thuhet se nga presionet e shqiptarve kjo familje u detyrua ta braktisë vendlindjen e tyre dhe të vendosen për të jetuar në disa fshatra të Anamooravës.

Kjo hipotezë është ngritur për qëllime politike, sepse të dhënat historike dhe burimet nga terreni ofrojnë argumente tjera bindëse, se të dhënat serbe, kishin për qëllim që të fshehin të vërtetën për nacionalitetin dhe origjinën e familjes së Uroshëviqit. Sido që të jetë kjo lenë të kuptohet se në burimet serbe, nuk ka të dhëna të sakta për origjinën e kësaj familje.

Duke u bazuar në burime historike për Hoçën e Madhe, por edhe për vet qytetin e Prizrenit, kuptojmë se popullata e këtyre dy vendbanimeve, gjatë mesjetës së vonë e deri në luftërat ballkanike, nuk ishte me origjinë serbe, por atje që nga fillimi i shekullit XIX, vepronte shtetë rusë për serbizimin e popullatës ortodokse.

Të dhënat tjera dëshmojnë se gjatë shekullit XIX, në qytetin e Prizrenit nuk kishte kurrfarë presioni ndaj popullatës ortodokse.


Në anën tjetër dihet fare mirë që sipas platformës pansllaviste që e udhëhiqte Rusia, që nga fillimi i shekullit XIX, i bëhej presion P. Osmane për dhënien e privilegjeve dhe disa të drejtave për ortodoksët brenda kufijëve të P. Osmane. Këto të drejta madje ishin nënshkruar në disa marrëveshje që ishin arritur në mes të Rusisë dhe P. Osmane, që nga fundi i shekullit XVIII. Bazuar në këto dëshmi historike kuptojmë se popullata ortodokse e Prizrenit, Hoçës së Madhe dhe vendbanimeve tjera në trojet shqiptare, nuk kishin pasur kurrfarë presioni prej

shqiptarëve gjatë kësaj periudhe, sepse të drejtat e tyre mbroheshin nga administrata osmene me ferman (ligj).

Burimet historike dëshmojnë, se pas fitimit të autonomisë së Serbisë, në vitin 1833 P. Osmane lejon hapjen e shkollave laike serbe edhe në territorin e Kosovës së sotme, dhe pikërisht shkolla e parë laike në gjuhën serbe, në vitin 1836 është hapur në qytetin e Prizrenit. Pak dekada më vonë u hapën edhe disa shkolla serbe në qytete dhe fshatra të Kosovës. Në Prizren është hapur edhe seminari ortodoks Bogosllavia, qysh në vitin 1871, në të cilën shkollë përgatiteshin klerikët dhe mësime të ndryshme për kisha dhe shkolla serbe në Kosovë.

Pra siç shihet nga burimet e kohës dhe dokumentet arkivore, në qytetin e Prizrenit, që nga fillimi i shekullit XIX, ishin hapur sholla në gjuhën serbe, me të vetmin qëllim serbizimin e popullatës ortodokse shqiptare dhe vllahe në qytet.

Këto shkolla serbe u zgjeruan dhe punuan pa asnjë ndërprerje gjatë gjithë shekullit XIX. Gjatë dekadave të fundit të shekullit XIX, në shumë vendbanime u ndërtuan shkolla të reja për djem edhe për vajza, dhe në këto shkolla, mësimi zhvillohej sipas plan programeve arsimore të Serbisë.



Сл. 2.
Прва општинска шк. зграда у Призрену подиг. 1836. г.
(Фотокопија из књиге П. Костића — Просв. кул. живот)



Сл. 7.
Зграда основне школе у Великој Хоћи
(Фототека „Пр. прегледа“ у Београду)

Foto 1. Objekti i shkollës së parë fillore serbe e hapur në vitin 1836 dhe Foto 2. Objekti i shkollës serbe të hapur në fshatin Hoçë të Madhe , në vitin 1872

Në këto shkolla nxënësit frymëzoheshin për kulturën dhe gjuhët sllave, historinë e sllavëve, fenë ortodokse, mësoheshin lënë të posaçme nga religjioni, ku shpjegohej për kishat e Kosovës, dhe këndoheshin këngë nacionaliste serbe për ngritjen dashurisë dhe moralit të nxënësve për gjuhën serbe dhe sllavët në përgjithësi.

Në fund të shekullit XIX, u ndërtuan mjaftë shumë shkolla të reja edhe në shumë fshatra. Në këto shkolla u përfshinë një numër mjaftë i madh i nxënësve.

Në këto shkolla nxënësit u ndanë sipas gjinisë, kështu që u hapën shkolla për meshkuj, por edhe për femra.



Сл. 14.

Основна школа „Младен Угаревић“ у Призрену
(Фототека Покрајинског завода за унапређење школства у Приштини)
Shkolla fillore Mladen Ugarevic, në Prizren

1. Основна школа (мушка) у Призрену	206	207	230	250
2. Основна школа (жен.) у Призрену	72	59	88	75
3. Основна школа у Ђаковици	26	21	16	20
4. Основна школа (муш.) у Пећи	185	172	157	133
5. Основна школа (жен.) у Пећи	70	73	68	61
6. Основна школа у Љубици	12	18	25	10
7. Основна школа у Средској	27	49	45	60
8. Основна школа у Горњем Селу	27	34	25	35
9. Основна школа у Великој Хочи	28	19	19	14

Numri i nxënësve në shkollat serbe të Prizrenit dhe Hoçës së Madhe, në vitin 1906

Po ashtu është e ditur se në dekadat e fundit të shekullit XIX, shkolla serbe u hapën edhe në qytetin e Gjilanit dhe dy fshatra tjera të kësaj komune, në Ranilluk dhe në Petrovc.

Urosevici shkollën fillore e kreu ne Gjilan në gjuhën serbe, andaj shtohet pyetja logjike: Pse familja pas mbarimit të shkollës fillore, nuk e dërgojë Uroseviqin të vijoje mësimet në shkollën e mesme në gjuhën serbe, por e dërguan që të mësoj në gjuhën turke!

Kuptohet se në këto kohë ishin vetëm shqiptarët që e kishin të ndaluar që të mësojnë dhe hapin shkolla në gjuhën shqipe.

12. Основна школа (жен.) у Приштини	60	101	88	63
13. Основна школа (муш.) у Приштини	175	204	184	238
14. Основна школа (муш.) у Ѓњилану	152	127	167	155
15. Основна школа (жен.) у Ѓњилану	27	49	56	56
16. Основна школа (муш.) у К. Митров.	52	51	51	74
17. Основна школа (жен.) у . Митров.	28	27	23	23
18. Основна школа (муш.) у Вучитрну	115	83	88	76

Numri i nxënësve në shkollat serbe të Prishtinës, Gjilanit, Mitrovicës, Vushtrrisë, në vitin 1906

Përveç kësaj në qytetin e Prizrenit, Rusia e kishte dërguar si konsull, diplomatin e vet Ivan Stepanovic Jastrebovin, i cili gjatë misionit të tij, zhvillojë propagandë dhe aktivitete pansllaviste në Prizren, Shkodër dhe Mirditë. Të gjitha aktivitetet e Jastrebovit dhe platformës pansllaviste ruse ishin në funksion të serbizimit të popullatës ortodokse në Prizren dhe rrethinë, si dhe në qytetin e Shkodrës.

Jastrebovi i cili në Rusi ishte arsimuar për të marrë njohuri për kulturën orientale, dhe gjuhët e lindjes, i fliste dhe shkruante në gjuhët: arabisht, persisht dhe turqisht. Menjëherë pas vendosjes së tij në Prizren ai i mori të gjitha masat, që të zbatohen të gjitha të drejtat e ortodoksëve, sipas fermanëve që ishin nënshkruar deri në atë kohë, në mes të Ruisë dhe P. Osmane.

*Одмах по доласку у Призрен преду-
зео све оне мере код вилајетских власти да се обез-
беде она права и загарантује онолика сигурност пра-
вославнима у призренском вилајету колику обезбеђу-
ју турски закони. Пронашао је све турске фермане*

Teksti ku tregon se Jastrebovi i kishte siguruar të gjitha fermanët osmane dhe kërkonte që të zbatoheshin me përpikëri.

Këto që i ofruam janë dëshmi të mjaftueshme, për ta kuptuar se nuk kishte kurrë far presioni ndaj ortodoksëve në Prizren dhe rrethinë, pra ashtu si shkruan në biografën e Urosevicit. Përkundër dhunës ndaj shqiptarëve në qytetin e Prizrenit,

gjithnjë e më shumë vinin duke u shtuar të drejtat, për popullatën ortodokse. Nga këto privilegje për ortodoksë në P. Osamne, që ishin arritur në saj të politikave, tani kishte filluar procesi i serbizimit të tyre.

Me rastin e formimit të Vilajetit të Kosovës, pikërisht në qytetin e Prizrenit, fillojë të botohej gazeta e parë në gjuhën turke dhe gjuhën serbe, dhe redaktor i kësaj gazete për gjuhën serbe, ishte caktuar Todor Stankovici nga Nishi, i cili më vonë u emërua konsull serbë në Prishtinë.



Gazeta në gjuhën serbe dhe turke si dhe këngë nacionaliste serbë që këndoheshin në shkollat serbë të hapura në Kosovë.

Në vitin 1868 u formua këshilli arsimor për ndihmë shkollave dhe mësuesve serb në trevat shqiptare që ishin në sundimin e Perandorisë Osmane. Shkollat laike serbe në atë kohë punonin sipas planit e programit të shkollave të Serbisë duke përdorur tekste të njëjta, organizim, metodat e mësimit dhe administrimit. Në trevat shqiptare u hapën shkolla të reja me mësuesit që i sillnin nga rajonet sllave. Nikolla Musolini, ishte një mësues që kishte ardhur nga Kroacia për të dhënë mësim në shkollat fillore serbe që ishin hapur në Kosovë.

Në këto shkollat serbe që u hapën në Kosovë, nxënësit fitonin njohuri më të mëdha se në disa shkolla në Serbi.

Siç e cekëm me qëllim të serbizimit të ortodoksëve, në këto shkolla këndoheshin këngë nacionaliste dhe trimërie për serbë, në mënyrë që të shtohet morali i nxënësve për Serbinë.

Përveç shkollave laike serbe që ishin hapur në shumë vendbanime të Kosovës, në qytetin e Prizrenit ishte hapur edhe shkolla kishtarë “Bogoslavija” me qëllim që ti përgatitë mësuesit dhe klerikët e rijë për të punuar në Kosovë.

Gjatë kësaj periudhe Patriarkana e Stambollit, e cila ishte mjaftë shumë e privilegjuar nga sulltani ishte në kundërshtim me kishën ortodokse serbe, dhe nuk

lejonte që të mbaheshin lutjet në gjuhën serbe në kishat më të mëdha në qytetin e Prizrenit.

Po ashtu nga vet burimet serbe mësojmë se që nga viti 1830, kur Serbia e fitojë autonominë e deri në vitin 1896, kishat në Prizren, Ferizaj dhe Lipjan ishin në duar të grekëve, ndërsa pas vitit 1896, dëbohen klerikët grekë, dhe në kishat ortodokse emërohen klerikë serbë. Pra deri në këtë kohë kisha e Shën Premtes në qendër të qytetit ishte në duar të klerikëve grekë.

Благодаря привилегированного положения цариградского патриарха в Турции, влияние греческой пропаганды было огромно. Центр этой пропаганды была митрополия в Призрене, которая была в руках греков од 1830 до 1896 года. — Греки свою пропаганду проводили через цинцарское население в Призрене, Урошевце и Липляну, и в некоторых других местах, а также и помощью немногочисленных своих монахов в сербских монастырях.

Dëshmi nga autorët serbë se në pjesën dërmuese të kishave ortodokse në territorin e Kosovës, deri në vitin 1896, liturgjia mbahej në gjuhën greke.

Mitropolia e Prizrenit gjatë kësaj periudhe ishte në duar të klerikëve grekë dhe Patriarkanës së Stambollit, por gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX, nga aktivitetet e politikës ruse e sidomos të Jastrebovit, tri kisha të qytetit të Prizrenit, u përvetësuan dhe u rinovuan, pas renovimit të këtyre kishave, klerikët sllav, lutjet i filluan në gjuhën serbe, për të vetmin qëllim, që tani e kishin shndërruar në platformë politike, serbizimin e vllahëve në qytetin e Prizrenit.

У Призрену има 26 цамија; православни Срби имају 3 цркве (црква Св. Ђорђа, Св. Николе и Св. Спас).

Dëshmi nga burimet serbe se deri në vitin 1892, se vetëm në tri kisha të Prizrenit, lutjet mbaheshin në gjuhën serbe.

Duke i pas parasysh të gjitha këto fakte, nuk qëndron ajo që shkruhet në biografinë e Urosevicit, kinse familja e tij, si dhe shumë familje tjera prej Prizrenit lëvizën, për të kërkuar kushte më të mira për jetesë dhe punë, ose për ta fshehur origjinën e tyre nga shqiptarët, siç shkruhet në burimet serbe!

Në fakt këtu nuk kemi asgjë tjetër, vetëm se një përpjekje e ulët, për ta fshehur origjinën shqiptare të familjes së Urosevicit, dhe shumë familjeve tjera serbe sot në Kosovë, të cilat u serbizuan pas pushtimit të Kosovës në luftërat Ballkanike.

Nga kjo që shihet, as që ka kuptim të mendohet, se ka diçka të vërtet nga ajo që shkruhet në biografinë e tij, se kinse familja e Urosevicit, nga frika e shtypjes dhe hakmarrjes së shqiptarëve, prej Prizrenit apo edhe Hoçs së Madhe, vjen për të jetuar në trevën e Anamoravës.

Po ashtu në biografinë e tij gjejmë edhe të dhëna se familja e tij, ishte e lidhur ngushtë me disa vendbanime në zonën veri-lindore të Artanës si: Stanishor, Ropotovë, Kololeq, Rajonoc, Strelisë e Rahavicë. Kjo e dhënë të shtynë me menduar, se familja e Urosecit, në këto fshatra i kishte të afërmit e vet më të ngushtë, por që vet kjo familje nga këto anë, gjatë shekullit XIX, ishte vendosur për të jetuar në qytetin e Gjilanit.

Shikuar pozitën gjeografike, të fshatrave të përmendur në biografinë e Urosevicit, dhe duke u bazuar në tregimet gojore, të popullatës shqiptare të kësaj ane, arrijmë në përfundim se familja e Atanasije Urosevicit ishte me origjinë shqiptare nga fshati Tullarë sot komuna e Medvegjës. Burimet historike dëshmojnë se, fshati Tullarë deri në kohën kur u pushtua nga Serbia në vitin 1878, kishte qenë i banuar vetëm me popullatë shqiptare. Bazuar në rrëfime gojore, familja e Urosevicit, për shkaqe të një konflikti që e kishte pasur në Tullarë, në fillim të shekullit XIX, e kishte braktisur fshatin dhe ishte vendosur në fshatin Rahavicë, në veri të Strezocit në komunën e Dardanës. Gjyshi apo baba i Urosevicit, prej Rahavicës ishte shpërngulur në qytetin e Gjilanit, duke i lënë familjarët tjerë në Rahavicë.

Rahavica është një fshat i vogël malorë, që kufizohet me shume fshatra, që me kohë kishin popullatë shqiptare si Krilevën, Zajqecin, Hajkobillen e tj. Po ashtu ky fshat kufizohet edhe me Vananeshin dhe Gregjenikun, fshatra këto të populluara me popullatë ortodokse shqiptare, të cilat u serbizuan gjatë shekullit XX.

W Родови: Стојковићи (11 к., св. Никола); досељени из Тулара (Јабланица) пре 140 година од арбанашког зулума. —

Dëshmi nga shkrimi i Uroseviqit për sërëbët e Rahavicës, për të cilët shkruan se kishin ardhur nga fshati Tullar

Për fshatrat e malësisë së Galabit të kësaj ane, janë të njohura takimet dhe lojërat tradicionale shqiptare për ditën e Shën Gjergjit, që mbahej çdo vit te vendi i quajtur “Lerthat” në Gregjenik. Gregjeniku ishte fshat i njohur që e kishte edhe kishën e vet ortodokse. Në këto takime dhe gara, që u mbajtën deri në vitet shtatëdhjeta të shekullit XX, merrnin pjesë banorët e të gjitha fshatrat myslimane dhe ortodokse të kësaj ane.

Po ashtu për fshatin Vaganesh, edhe sot ruhen rrëfimet e familjeve shqiptare, se në atë fshat gjatë shekullit XIX u vendos një familje shqiptare nga fshati Marec. Këtë e pohon edhe vet Urosevici në librin e tij, kur thotë se para 170 viteve një familje nga Tirinca dhe një tjetër nga Mareci, u vendosën në këtë fshat.

Me qenë se këto familje shqiptare, ende se kishin pranuar islamizimin, me kalimin e kohës, pas pushtimit të Kosovës nga serbët u serbizuan. Dy familje shqiptare të serbizuar nga ky fshat, në vitin 1929, u vendosën në tokat e dy familjeve shqiptare nga fshati Krilevë, që u shpërngulën për në Turqi. Këto familje serbe, me familjet shqiptare në fshatin Krilevë dhe Marec, ishin në lidhje gjaku, dhe deri në vitin 2000, jetuan pranë njëri tjetrit, pa pasur ndonjë konflikt që vlen të përmendet.

Po ashtu për këto fshatra, shkruan edhe vet Uroshevici, i cili ndër tjera për Rahavicën thotë, se aty nuk ka banorë të moçëm, por para ardhjes së banorëve të rijë në këtë fshat, banorët më të vjetër ishin shqiptarët. Me siguri që banorët shqiptar, më parë mund të ishin vendosur në toka më pjellore, në Dardanë, Gjilan apo edhe vende tjera. Pra nga vet Urosevici, dëshmohet se fshati më parë kishte qenë i banuar me shqiptar, dhe kjo ka mjaftë shumë rëndësi për të ndriçuar të vërtetën e këtij fshati. Pas shqiptarëve që kishin qene në atë fshat, aty janë vendos familjet serbe Stojkovic, por pas vitit 1878, në këtë fshat u vendosën edhe shqiptar muhaxhir shkruan Urosevic. Po ashtu Urosevici shkruan se anëtarët e familjes Stojkovic që tani në Rahavicë numëronin 11 shtëpi, para 140 viteve, kishin ardhur prej fshatit Tullarë, kinse prej presioneve të shqiptarëve në atë fshat.

Kjo e dhënë përputhet tërësisht me rrëfimet e shqiptarëve, se pikërisht në fillim të shekullit XIX, një familje shqiptare pas një konflikti në fshatin Tullarë, u detyrua ta braktisë fshatin, dhe u vendos në Rahavicë. Meqenëse popullata e kësaj ane ende se kishte pranuar islamizimin, kjo familje që jetoi në Rahavicë me kohë është serbizuar.

Nga puna hulumtuese në terren kemi mësuar se, popullata e fshatrave të Dardanës, Gjilanit dhe Artanës, që kishte jetuar para luftërave ballkanike në këto anë, që sot njihet si popullatë serbe, ishte me origjinë shqiptare, por që u serbizuan pas pushtimit të Kosovës nga serbët.

Po ashtu nga hulumtimet në terren është vërtetuar, se popullata shqiptare e malësisë së Galabit, kishte qenë e krishterë, ku disa vendbanime kishin qenë të besimit katolik dhe disa tjera të besimit ortodoks. Procesi i islamizimit të plotë të kësaj treve, kishte zgjatur deri në vitin 1912. Ruajtja e besimit të krishterë deri në gjysmën e dytë të shekullit XIX, në rrethinën e Gjilanit, ishte bërë e mundur sepse Gjinollët e Gjilanit dhe të Vrajës, kryesisht ishin martuar me gra ortodokse, madje edhe vet Gjinollët, ndërtuan kisha për ortodoksët në këto anë. Po ashtu është e ditur se Gjinollët ishin të përpiktë, në zbatimin e fermanëve osmane, ku lejoheshin privilegje të shumta për ortodoksët.

P. Osmane i kishte nënshkruar disa fermanë, pas humbjes së luftës kundër Rusisë në vitin 1812, andaj kjo dëshmon se ortodoksët edhe në rrethinën e qyteteve ku sundonin Gjinollët, nuk kishin presione nga shqiptarët.

Nga shumë trungje familjare të hulumtuara në këto anë, dëshmia për paraardhësit e tyre katolik, ruhet prej brezit të gjashtë, e të disa familje deri në brezin e tetë. Kjo dëshmon bindshëm që deri në shekullin XIX, edhe përkundër pushtimit qindra vjeçar nga P. Osmane, malësia e Galabit të epërm, mundë të shkelej vetëm me fushata dhe ekspedita të mëdha ushtarake, sepse gjatë gjithë kohës kontrolloheshin nga shqiptarët dhe këto vise ishin të pa kalueshme edhe për zyrtarët turq.

Me shpalljen e reformave të tanzimatit, ku identifikimi i popullit bëhej sipas religjionit, me të vetmin qëllim asimilimin dhe shkrijen e popullatës së lashtë ilire në popuj tjerë, prandaj ky ishte projekti më antishqiptar i përgatitur nga Rusia e vendet evropiane në bashkëpunim me P. Osmane.

Tani sipas këtij projekti, të gjithë u lëshuan në gjah, kundër një popullate të pa mbrojtur, duke bërë garë mes veti, se kush po mundet të vras dhe asimiloj sa më shumë shqiptar. Natyrisht se me këto reforma, nuk u pajtua popullata shqiptare, dhe për këtë arsye me të drejtë, parashtruan kërkesa për të drejta kulturore e autonome në trojet e tyre.

P. Osmane nuk e plotësoi asnjë kërkesë të shqiptarëve, andaj popullata pa marrë parasysh religjionin, u bashkua në kryengritje të armatosur kundër P. Osmane.

Në vitin 1843, kurë porta e lartë, e proklamojë “Hatisherifin e Gjylhanes” në Kosovë, kjo nuk u prit mirë nga popullata shqiptare, menjëherë filluan trazirat dhe popullata u ngrit në kryengritje. Zemërimi i madh i shqiptarëve ishte shtuar, kur përveç shtimit të madh të taksës, regrutimit të dhunshëm të shqiptarëve në ushtrinë osmane, porta e lartë fillojë zëvendësimin e zyrtarëve shqiptar, me funksionar dhe zyrtar osman, dhe fillojë shtimin e masave represive, për islamizimin e popullatës, dhe osmanizmin e administratës në trojet shqiptare.

Ushtria e rregullt e sulltanit, e dërguar në trojet shqiptare, ndërmerre masa çnjerëzore, dhe bënë presion shumë të madh, ndaj kriptkatolikve shqiptar në Shqipërinë veriore, me qëllim që të shtoi zhvillimi e procesit të islamizimit të popullatës shqiptare.

Një numër i madh i popullata shqiptare në viset veriore, edhe pas shumë sakrificave deri në këtë periudhë, ju kishin përballuar të gjitha presioneve të pushtetit osman, që kishte ndërmarrë për islamizimin e dhunshëm të shqiptarëve.

Pas shpalljes së reformave të reja, ku identifikimi i kombit bëhej sipas religjionit, shqiptarët e islamizuar detyroheshin të regjistroheshin si osmanlinj. Pjesa tjetër, dërmuese e shqiptarëve të kësaj ane, për ti shpëtuar këtij procesi, u detyruan të regjistroheshin si bullgar, serbë dhe kroat.

Kjo ndjekje e shqiptarëve nga malet e Galabit, kishte ndodhur për shkak të pjesëmarrjeve të tyre në kryengritje, andaj kundër tyre dhe u morën masa të ashpra

nga ushtrisë osmane. Po ashtu një numër i madh, i familjeve shqiptare ortodokse, nga fshatrat e Artanës, Dardanës, Gjilani, Preshevës, Vrajës, Leskocit dhe viseve tjera shqiptare, gjatë kryengritjeve të viteve dyzeta të shekullit XIX, u detyruan të shkruhen si jo shqiptar.

Është me rëndësi të ceket se, gjatë gjithë kryengritjeve shqiptare, që u zhvilluan gjatë shekullit XIX, popullata shqiptare, kriptokatolike e zonave më të thella veriore shqiptare, u bashkuan me kryengritësit shqiptar, pa marrë parasysh se kush i udhëhiqte kryengritjet, pashallarët apo klerikët mysliman shqiptar. Kjo u dëshmuar, edhe gjatë kryengritjes së Mustafa Pash Bushatliut, dhe më vonë edhe nën udhëheqjen e Dervish Carës.

Popullata shqiptare ortodokse që u serbizua, në gjysmën e dytë të shekullit XIX, dhe gjatë shekullit XX, me ndikimin e politikës dhe kishës ortodokse serbe, i përvesuan të gjitha objektet e kultit, dhe përmes procesit të konservimit e restaurimit, më qëllim të falsifikimit të historisë së tyre, gjurmët e kulturës shqiptare u dëmtuan dhe u falsifikuan.

Popullata shqiptare katolike e zonës së Moravës, Vardarit, Velesit, Prilepit, Kosovës së sotme dhe malësia në mes të Prishtinës, Nishit e viseve tjera shqiptare, u treguan shumë aktiv në kryengritjet shqiptare, që i zhvilluan Mustafa Pashë Bushatliu e më vonë edhe Dervish Cara. Kjo dëshmohet edhe në kryengritjet shqiptare për ta marrë Prishtinën, Leskocin, Vrajën, Shkupin e qytetet tjera shqiptare.

Me këtë shembull unë po e veçojë, rolin e popullatës së krishterë shqiptare, që morën pjesë për ta marrë në dorë qytetin e Vrajës.

Popullata shqiptare katolike e Moravës, sipas reformave të shpallura, ishte regjistruar si popullatë bullgare, kjo shkaktoi revoltë të popullata shqiptare e krishterë, e cila u bashkua në kryengritje, krahas vëllezërve të tyre mysliman, kundër portës së lartë.

Nën udhëheqjen e një shqiptari katolik, të quajtur me emrin Festol (banor i krishter nga fshati Tërrnoc), kryengritësit nga Tërnoci, Selam Rogoqica nga Dardana (Kamenica), Ymeri nga Presheva, dhe bejlerët e ajanët tjerë nga Presheva, Bujanoci e Vraja, në vitin 1843, e përmbysen sundimin e Hysen Pashës në Vrajë. Shqiptarët ortodoks të Tërnocit, në ato vite me që ishin të krishterë, sipas reformave osmane, ishin detyruar të regjistroheshin si bullgar.

Banorët shqiptar ortodoksë në Tërrnoc dhe disa fshatra tjera, për ta mohuar kombësinë bullgare, dhe për ta ruajtur dhe identitetin, u detyruan që ta pranonin islamizimin. Banorët shqiptarë të këtyre anëve nuk hoqën dorë nga gjuha, veshja dhe tradita kombëtare, por këto vlera i ruajtën me mjaftë xhelozë. Burimet e dëshmuara nga terreni, vërtetojnë se shumë familje u ndanë në dy grupe, ku disa e pranuan kombësinë bullgare, ndërsa të tjerët e refuzuan.

Është e ditur se qysh në fund të shekullit XVIII, sipas platformës pansllaviste ishte paraparë që nga lugina e Lumit Moravë të shpërngulën shqiptarët, dhe sipas kësaj platforme filluan që lumin ta quajnë Morava Bullgare.

Pra shihet qartë se vetëm shqiptarëve, nuk ju njihej e drejta elementare e identitetit kombëtar, madje sipas platformës ruse, dhe lumin që buron në Kosovë, e deri në mes të Paraqinit, Pallankës dhe Qyprisë sllavet e quanin Morava Bullgare.

Kufijtë e Serbisë autonome të vitit 1830, në atë kohë vinin deri te Bashkimi i Moravës bullgare me Moravën serbe (Dega tjetër e lumit që kalonte mbi Krushec dhe bashkohej me lumin Morava, serbët filluan ta quajnë si Morava serbe).

На истоку: гребен планине која према Старој Оршави силази ка Дунаву, а која је даље јужно водомеђа која раздваја Тимок и Поречку Реку, водомеђа између Параћин-паланке и Ђуприје, Морава. За тим уз Мораву до оне тачке где се сливају Српска и Бугарска Морава.

Јужна граница. Три сата од Српске (западне) Мораве на више, даље отпада на југ, како где, 1—2 сахата од десне обале, до Чачка, — даље опет отпада југозападно и на 9 сахати од Пожеге додирује горњу Српску Мораву.

Kufiri lindor dhe jugor i Serbisë autonome, dhe dëshmia se deri në Paraqin, lumi quhej Morava bullgare, edhe pse dihej se në atë kohë ky lum deri në ato vende, kalonte nëpër trevat që quheshin Arnautlluk (Albani).

Ushtria osmane pasi i nënshtrojë shqiptarët në Vrajë dhe Leskoc, bëri një hakmarrje të turpshme, ndaj popullatës së krishterë shqiptare, që ishin bashkuar me shqiptarët mysliman, kundër reformave, por dhe për dëbimin e Hysen Pashës, dhe bandës së tij nga qyteti i Vrajës.

Pas këtij nënshtrimi, ushtarët osman u lanë të lirë, që të bëjnë çka të donin me popullatën shqiptare, kështu që në fshatin Tërnoc, dhe disa fshatra tjera përveç plaçkës, ushtarët osman çnderuan edhe gratë e vajzat e popullatës shqiptare.

Rol të madh në këto kryengritje kishte edhe Ismajl Pasha i Leskocit, dhe popullata shqiptare e krishterë e asaj zone.

Ismajl Pasha i Leskocit, kryengritësit i furnizonte më ushqim dhe kuaj. Kryengritësit shqiptar ndiqeshin nga ushtria osmane, që në përbërje të saj, ishin përfshirë edhe shqiptarët e jugut të Shqipërisë, që i udhëhiqte Omer Pash Latasi.

Kur ushtria e Omer Pashës hyri në Leskoc me 20 qershor 1844, ajanët e Leskocit ju bënë pritje ushtrisë së sulltanit, ju përgatitën ushqime, dhe ju dorëzuan të gjitha parat që i kishin mbledhur në popull, për organizimin e kryengritjes. Me 5 Prill

1845 Ismajl Pasha i Leskocit u kap, dhe me tërë familjen e tij, u dërgua në Azinë e Vogël, të cilët u zhdukën pa lënë gjurmë.

Gjatë kësaj përndjekje ushtria osmane në Leskoc, nguli 50 hunj për ngulitjen e kryengritësve shqiptarë. Me ngulitjen e kryengritësve shqiptar në hunj, popullata u dorëzua dhe në qytet u vendos administrata osmane.

Pas shuarjes së kryengritjeve shqiptare, ushtria osmane që kishte marshuar drejtë Vrajës, dhe fshatrave e qyteteve shqiptare në veri të saj, sipas disa burimeve të kohës, thuhet se në këto anë, u mbledhën me dhunë 10.000 ushtarë të rregullt, për ushtrisë perandorake osmane.

Gjatë qëndrimit të tyre në këto anë, ata bënë tortura, dogjën fshatra të tëra shqiptare, dhe u imponua me dhunë islamizimi dhe dorëzimi i kryengritësve.

Sipas platformës së reformave të tanzimatit, u kërkua që përfundimisht të hiqet dorë, nga kriptokatolicizmi i popullatës shqiptare, në malësinë midis Nishit, Prishtinës dhe Shkupit.

Popullata shqiptare e krishterë e këtyre anëve, e sidomos ajo në viset e thella malore, ku nuk u vërejtën krimet e ushtrisë osmane. Pasi që atje nuk arritën vëzhguesit e huaj, nga dhuna e ushtruar nga ushtria e Omer pashë Latasit, popullata shqiptare u detyrua që përfundimisht të heq dorë nga feja katolike, dhe ta përqafojnë islamizimin.

Franceskanët në ato rrethana, nuk patën mundësi ta përcillnin gjendjen e popullatës katolike shqiptare në ato anë, madje as në anën veriore të fshatrave shqiptare që shtriheshin në veri të Peshterit afër Janjevës.

Duhet theksuar se popullata shqiptare e zonës së Vrajës, Leskocit, Artanës dhe qyteteve tjera veriore e kishte përballuar për disa shekuj presionin e ashpër të P. Osmane, për myslimanizmin të plotë deri në vitet 1843/44.

Ushtria e rregullt e sulltanit, që u dërguar në trojet shqiptare, ndërmerre masa çnjerëzore, dhe bënë presion shumë të madh, ndaj kriptkatolikve shqiptar në Shqipërinë veriore, me qëllim që të shtoi zhvillimi e procesit të islamizimit të popullatës shqiptare.

Se popullata shqiptare e kësaj zone, me shekuj e kishte ruajtur gjuhën, traditën dhe kulturën e lashtë dardane, dëshmohet edhe prej studiuesve të huaj, që i vizituan viset tona gjatë asaj periudhe.

Për ruajtjen e objekteve të kultit, ndërtimin e kishave arbërore, si dhe përballimin e islamizimit deri në gjysmën e shekullit XIX, kanë shkruar më vonë edhe disa studiues serbë. Atanasije Urosevici, gjatë studimeve të tij dhe hulumtimeve në terren, ofron të dhëna edhe për islamizimin e vonshëm të familjeve shqiptare në Malësinë e Galabit.

Siç shihet edhe nga hulumtimet e tij, në kohën kur ai i ka bërë, në brezin e katërt familjet shqiptare të kësaj treve ishin të krishterë.

Për islamizimin e vonë të shqiptarëve po e ofrojmë këtë të dhënë nga Urosevici, andaj ne e shkëputëm një faqe nga libri i tij.

ска и муслиманска. Арбанашки родови Геца и Рулан у Рогачици су досељени у католичкој вери, па, иако су њихови преци одмах по досељењу прешли у ислам, зна се да су задуго били у привидном исламу, односно у криптокатоличанству. Када се за тридесетак година доцније (пре око 140 г.) један део рода Рулана преселио у Ново Село (у сливу Карачевске Реке), у њему се међу његовим прецима јавља и хришћанско име (Сабедин, Мусли, Имер, К о љ а). Род Дода у Свирцу је досељен као „стара вера“. Предак арбанашких родова у Трстени звао се Пренк и, како веле, до Изморника је при досељавању гонио своје свиње. Арбанашки родови у Бусовату и Доњем Макрешу су до пре 4 појаса били католици.



Сл. 8. — Арбанаси из Свирца.

Забележено је по предању да су из ове области Арбанаси прелазили у Пољаницу као хришћани и да су са собом гонили свиње. У ислам су прелазили по настањивању у Пољаници.⁸⁵ Арбанаси села Брасаљци су се чак и у другој половини прошлога века сматрали за „љармане“ тј. за тајне католике. Код појединаца се ово криптокатоличанство одржавало и до ослобођења (1912).⁸⁶

Siç shihet edhe nga shkrimet e Urosevicit vërehet se para ardhësit e familjeve shqiptare të islamizuara në këto anë, shkonin deri te brezi i katërtë, për të dëshmuar besimin e krishterë. Sot kjo dëshmi vërtetohet fare lehtë se shkon deri në brezin e gjashtë.

Nga këto të dhëna kuptojmë se deri në këtë periudhë, popullata shqiptare ju bëri ballë, të gjitha sulmeve dhe projekteve osmane e ruse, për ta ndërruar fenë.

Edhe pse kësaj kryengritje në veri ju prinë klerik mysliman, nga ngjarjet e zhvilluar të kohës, mësojmë se kryengritjen e armatosur e përkrahën të gjithë shqiptarët katolik dhe ortodoksë të kësaj ane, duke u solidarizuar me vëllezërit e tyre mysliman.

Popullata shqiptare ortodokse që u serbizua, në gjysmën e dytë të shekullit XIX, dhe gjatë shekullit XX, me ndikimin e politikës dhe kishës ortodokse serbe, i përvësuan të gjitha objektet e kultit, dhe përmes procesit të konservimit e restaurimit, më qëllim të falsifikimit të historisë së tyre u dëmtuan.

Këtë e dëshmojnë edhe disa autor serbë, të cilët kanë lënë shënime për kishën shqiptare në qytetin e Leskocit. Ata shkruajnë për ndërhyrjen në freskat e kishës së Leskocit që ishte konservuar në vitin 1693, kur të gjitha freskat, mbishkrimet dhe fotografitë u ndryshuan në vitin 1902 dhe rreth vitit 1930, nga padituria për mos kuptimin e tekstit origjinal. Krejt këto kishin ndodhur pasi që këto punë u lanë në dorë të një të riu rusë shkruajnë serbët.

Петковић пише да су приликом обнављања живописа 1693. године „сви натписи код слика произвољно измењени из неразумевања првобитнога текста“; али не каже ништа да су фреске ове цркве „дотериване“ и доцније, 1902. и око 1930. године. (Ове последње и невештом руком неког младог Руса).

Dëshimi të shkruara nga autorët serbë, për ndërhyrjen e rusëve për të falsifikuar kishën shqiptare në Leskoc.

Nga kjo e dhënë kuptojmë se rusët që nga mesi i shekullit XVII, veprimin e tyre e kishin shndërruar në platformë politike dhe ushtarake, që të zhdukin çdo gjurmë të shqiptarëve në trevat ilire. Shërbimet sekrete ruse gjatë gjithë kësaj kohe punuan për formimin e shteteve sllave dhe shtetin grek në tokat ilire.

→ Русија је тајном конвенцијом из 1877. године добила Бугарску. Она је активно радила на стварању велике Бугарске чије би границе обухватиле и Македонију, део Србије и део данашње Албаније. Таквом Бугарском Русија је желела да створи стратешки важан чвор на Балкану за борбу око мореуза и за Средоземље. Поред тога, Русија је настојала да прошири свој утицај и на оне територије Балкана које су остале изван граница утицајних сфера двеју сила. Када је

Dëshmi që Rusia e planifikonte zgjerimin e Bullgarisë në trojet shqiptare e sidomos në Anamoravë dhe lumin e sotëm Vardar.

Nga teksti lartë kuptojmë se Rusia prej vitit 1877, me të gjitha shërbimet e veta sekrete kishte punuar që ta formoje Bullgarinë e madhe e cila do të shtrihej në territoret e Serbisë, Maqedonisë dhe Shqipërisë së sotme. Një Bullgari të tillë e dëshironte Rusia për çështje strategjike në Ballkan.

Se popullata e Leskocit deri në krizën lindore ishte me popullatë shqiptare, i kemi edhe të dhënat që i kane botuar vet serbët për vizitën që i bënë qytetit Georg Von Hahn në vitin 1858. Mes tjerash Hahn për qytetin shkruan ishte me shtëpi të bukura, por ajo që i kishte lënë shumë përshtypje ishte shtëpia e Ismajl Pashës. Shtëpia e ismajl Pashës në Leskoc dhe shtëpia e Mahmut Begollit në Pejë, janë më të njohurat në tërë Shqipërinë. Pra siç shihet në ato vite e deri në vitin 1878, tërë Sanxhaku i Nishit quhej Shqipëri, madje edhe vet serbët e quanin Arnautlluk (Shqipëri).

једно са његовим братом одредила на друге дужности. Но и сам Рам
означио ми је куће Исмаил-паше и Махмуда Беголи у Пећи као нај-
знатније у целој Албанији. Он ми је, у једном поверљивом разговору,
даље изјавио да му за наш пут не требају мудирови људи, већ да ће
повести своје.”² *Олковић*

Dëshmi e shkruara nga Georg Von Hahn, për arkitekturën popullore shqiptare, dhe se Leskoci në ato vite konsiderohej si qytet shqiptar.

Shqiptarët e këtij rajoni, ishin të njohur si tregtar të zotët dhe ndërtues të mirë të objekteve të banimit. Shtëpitë e bejlerëve shqiptar të ndërtuara në Krushec, Leskoc dhe Vrajë sot ruhen si objektet ma arkitekturën më të zhvilluar gjatë shekullit XVIII e XIX, dhe janë shndërruar si muze të këtyre qyteteve.

Të gjitha këto argument shtesë janë dëshmi tjera se popullata që jetonte në mes të Leskocit-Prishtinës dhe Shkupit ishte shqiptare e besimit ortodoks, katolik dhe mysliman, andaj bazuar edhe në të dhënat për biografinë e familjes së Urosevicit na shtynë të mendojmë se me qëllim është fshehur origjina e saj shqiptare.

Nga të gjitha burimet e përmbledhura për origjinën e familjes së Urosevicit shtohet edhe një pyetje logjike: Si është e mundur që Atanasije Urosevic të shkruaj për origjinën familjare gati të krejt popullatës së Kosovës e mos të lë shënime të sakta për origjinën e familjes së vet! A thua ky e dinte mirë se familja e tij nuk kishte pasur origjinë serbe, por që me dhunë ishte serbizuar si shumë familje tjera.

Të dalim prapë në temë rreth familjes së ngushte të Urosevicit. Bazuar në burimet e shkruara, babai i tij quhej Kosta, ndërsa e ëma quhej Mara. Mara ishte bijë e

familjes së Qamil Agës, e cila familje kishte prona, dhe shtëpi të bukur në qytetin e Vushtrrisë. Tani të mësojmë se kush ishte familja Qamili në qytetin e Vushtrrisë. Për qytetin e Vushtrrisë kemi të dhëna se gjatë vizitës që i bëri në mesin e shekullit XVII, udhëpërshkruesi turk Evlija Çelebit, shkruan se në këtë qytet flitet gjuha shqipe dhe ajo osmane, ndërsa nuk fliten gjuhët sllave. Kjo e dhënë na njofton për të kuptuar se në atë kohë nuk kishte popullatë sllave në këtë qytet, madje Çelebiu këtë trevë e quante Albani (Shqipëri).

Nga burimet historike mësojmë se si në shumë qytete ashtu edhe në qytetin e Vushtrrisë, gjatë shekullit XIX, për ortodoksët, ishin hapur shkolla serbe me lejen e P. Osmane. Një numër i ortodoksëve që kishin vijuar mësimet në shkollën serbe të këtij qyteti, me kohë u serbizuan. Nga shkolla serbe e Vushtrrisë, të brumosur me nacionalizëm serbë, dolën edhe disa vojvodë serbë që bënë krime të mëdha ndaj popullatës shqiptare në fillim të shekullit XX e sidomos gjatë luftërave ballkanike.




Сл. 1.

Школска зграда у Вучитрну-подигнута средином XIX в.
(Фотокопија из календара „Вардар“ за 1912. г.)

Shkolla në gjuhën serbe, e hapur në qytetin e Vushtrrisë në mesin e shekullit XIX

Për ti asimiluar shqiptarët, vllahët dhe disa familje që nga Korça e Voskopoja, në fund të shekullit XIX ishin vendosur në Lipjan dhe disa vendbanime tjera të Kosovës, gjatë shekullit XIX u ndërtuan shkolla fillore serbe.



Сл. 5.

Стара зграда осн. школе у Липљану крајем XIX в.
(Фототека Пок. државног архива у Приштини)



Сл. 6.

Основна школа у Грачаници — подигнута крајем XIX века
(Фототека Пок. држ. архива у Приштини)

Shkollat fillore serbe të ndërtuar gjatë shekullit XIX, në Lipjan dhe Graçanicë, kjo shtëpi që përfaqson banesën qytetare shqiptare të shekujve XVIII e XIX, është rrënuar nga pushteti serbë.

Pasi në qytetin e Gjilanit nuk kishte shkolla në gjuhën shqipe, edhe Urosevici, shkollën fillore e kreu në gjuhën serbe në qytetin e tij të lindjes.


Pas mbarimit të shkollës fillore në vitin 1910, e vazhdojë shkollën e mesme turke në qytetin e Prishtinës.

Lufta e Parë Ballkanike e gjeti atë në klasën e dytë në shkollën e mesme turke. Pasi ndërpritet mësimi në shkollën turke, ai kthehet në qytetin e tij të lindjes.



Сл. 18.

Натпис на шк. згради у Приштини из 1859. г.
(Фототека Покр. музеја у Приштини)



Сл. 15.

Факсимал насловне стране читанке „Косово“ из 1884. године (Фототека Покр. држ. архива у Приштини).

Mbishkrimi në objektin e shkollës serbe në Prishtinë në vitin 1959, dhe faksimile për faqet përmbledhëse të librit shkollorë të Kosovës, i vitit 1884 në Prishtinë.

Urosevic, në vitet shkollore 1913/14, i vazhdon mësimet në shkollën e mesme serbe në Shkup. Ai në Shkup u regjistrua në klasën e dytë dhe e mbaroi me sukses. Për shkak të Luftës së Parë Botërore, ai detyrohet të ndërpresë mësimet dhe të kthehet në familje. Pas mbarimit të Luftës së Parë Botërore, ai e vazhdoi shkollimin në Shkup, ku shkollën e mesme e mbaroi në vitin 1922 dhe u regjistrua në Fakultetin Filozofik në këtë qytet, në degën Gjeografi dhe Etnologji. Ai i mbaroi studimet në 1926, dhe më pas ishte asistent i paspecifikuar në këtë fakultet; Më 1927 (pasi mbaroi shërbimin e tij ushtarak), ai u zgjodh asistent në të njëjtin fakultet, ku mori doktoraturën në 1929. Gjatë viteve tridhjeta të shekullit XX, nuk kemi ndonjë të dhënë për aktivitetet e tij, por sipas të gjitha gjasave, aktivitetet e tij

ishin punë profesionale, me të cilat ishte ngarkuar nga pushteti. Siç shihet ai gjatë Mbretërisë serbo-kroate –Sllovene, kishte marrë edhe gradë ushtarake, sepse gjatë Luftës së Dytë botërore, ishte oficer rezervë i ushtrisë së Mbretërisë, dhe arrestohet nga gjermanët, i cili lirohet me 10 prill të vitit 1945.

Pas lirimit të tij, ai u zgjodh profesor i asocuar në Fakultetin Filozofik në Beograd, dhe në fund të vitit 1946 u transferua në Shkup në Fakultetin Filozofik, ku në vitin 1950 u bë profesor i plotë. Urosevici dha kontribut me hapjen e fakultetit në Prishtinë. Ai doli në pension në vitin 1964, por puna dhe veprimtaritë e tij nuk u ndalën këtu.

Nga viti 1971 deri në 1973, ai ishte drejtori i Institutit Etnografik të Akademisë Serbe të Shkencave dhe Arteve në Beograd. Urosevici vdiq në 17 tetor 1992, në Beograd ku edhe është varrosur.

Urosevici ka lënë disa publikime, kryesisht të punuara në terren për shume treva e vendbanime të Kosovës. Sidomos shënime të hollësishme ka lënë për Anamoravën, duke e përfshirë Gjilanin dhe qytetet tjera në rrafshin e Kosovës. Ka lënë pa botuar, rezultatet e hulumtimit për zonën e Llapit.

Nga jeta e tij është shumë me interes të dihet si ndodhi që Urosevici, në vitin 1910, të vijojë mësimet në gjuhën turke në Prishtinë. A ndikuan dajallarët e tij nga Vushtrria që ky të vijojë mësimet në gjuhën turke në Prishtinë.

Babai i Atanasije Urosevicit, Kosta ishte një abadžija (Zhguntar, ai që mbaron, shet dhe punon me zhgun). Nga veprimtaria e babës së tij mund të kuptojmë se ai ishte një zejtar dhe tregtar i pasur në qytetin e Gjilanit. Nëna e tij quhej Mara dhe ishte nga familja e famshme Qamili në Vushtrri). Shikuar nga aspekti ekonomik shihet se të dy këto familje ishin të pasura. Sipas të gjitha gjasave të dy këto familje ishin me origjinë shqiptare që me kohë për interesat e ekonomike të tyre familjare e kishin përqaftuar besimin islam.

Të shohim se kush ishin dajët e Atanasije Urosevicit: E ëma e Urosevicit Mara, ishte bijë e familjes së Ali Agë Qamilit nga Vushtrria. Për familjen Qamili në qytetin e Vushtrrisë nuk ka të dhëna të sakta, se kush ishin, nga vinin dhe përkatësinë e tyre kombëtare. Ajo që dihet se kjo familje jetonte në një shtëpi të bukur, dhe shumë luksoze për kohën e ndërtimit në qendër të Vushtrrisë. Kjo shtëpi për shkak të vlerave historike dhe arkitektonike, pas Luftës së Dytë Botërore ishte marrë në mbrojtje si monument kulture.

Për të siguruar më shumë informata për këtë familje dhe shtëpinë e tyre në Vushtrri, i kontaktova kolegët e mi të profesionit Bedri Xhemën, Burim Rexhepin dhe Jeton Sallahun. Me ndihmën e tyre fillova të mbledhë informatat e para për këtë familje.

Bedri Xhema si një njohës i mirë i objekteve dhe trashëgimisë kulturore në komunën e Vushtrrisë, më njoftojë se kjo familje, shtëpinë e ka pasur afër Entit për Punësim në qytetin e Vushtrrisë. Shtëpia ishte dy kate e ndërtuar me tulla dhe

kishte dritare të mëdha. Objekti ishte i mbuluar me qeramidhe tradicionale dhe e kishte një oborr prej 6 ari. Në oborr fare pranë shtëpisë ishte qeshma, e cila përdorej vetëm nga kjo familje. Sipas Bedriut, kjo shtëpi më parë kishte qenë e një begu shqiptar, i cili pas pushtimit të Kosovës ishte dëbuar në Turqi, pasta ai objekt ju dha në pronësi familjes Qamiloviq. Ajo qka mund të them më shumë për këtë familje, mendohet se ka origjinë nga Trepça.

Pas vitit 2000 kjo shtëpi ishte planifikuar që të shndërrohet në muze etnografik të qytetit, por ndërkohë është djegur.

Shtëpia kishte vlera dhe në hapësirat e brendshme, fasada ishte me plotë dekorime, dhe kur është djegur janë vërejtur tubat e qeramikës të kanalizimit dhe të ujës-jellësit. Një anëtar të kësaj familje Mishko Qamiloviqin, Bedriu e kishte pasur drejtor në shtëpinë e Kulturës në Vushtrri. Bedriu atë e kujton për njëri të arsyeshëm, dhe se lente përshtypje se kishte frikë nga ajo që bënin serbët në Kosovë. Bedriu kujton se në kohën kur është marrë vendimi për largimi e librave në gjuhën shqipe nga biblioteka e qytetit, me sugjerime të Bedriut, Mishko kishte vendosur që mos ti largojë librat në gjuhën shqipe, edhe pse më vonë serbët e kishin larguar nga puna. Fqinjë të parë e kishte Shaban Zekiqin.

Jeton Sallahu, në librin e tij të botuar: Çështje të historisë së Vushtrrisë me rrethinë, e ka përmendur shtëpinë e familjes Camilovic, por me të dhënat që i kishte marrë prej Bedri Xhemës. Jetoni kujton rrëfimet e Bedri Xhemës, se kur serbët e paskan larguar fotografinë e Hasan Prishtinës, Mishko Qamiloviqi ishte mërziur mjaftë shumë.

Burim Rexhepi, përmes një mikut të tij nga Vushtrria, ka marrë disa informata për Misko Camilovicin. Misko Camilovic paska deklaruar se familja e tij është familja më e vjetër e qytetit të Vushtrrisë. Po ashtu sipas Camilovicit, pas tyre si familje e vjetër në Vushtrri paskan qenë Vllajiqët. Burimi, paska marrë informata se kjo familje e kishte pasur edhe një shtëpi tjetër përballë çerdhes së fëmijëve në qytetin e Vushtrrisë.

Nëse kjo është e vërtet atëherë ne kemi burime se në shekullin e XVII, se në qytetin e Vushtrrisë nuk fliteshin fare gjuhët sllave, andaj edhe kjo familje nuk mund të ishte sllave.

Stanovništvo toga šehera je rumeliski narod. Oni ne znaju da govore bošnjački, nego govore arbanski i turski. Oni nose odjeću od

Dëshmi të publikuara për strukturën e popullatës së Vushtrrisë, gjatë vizitës së Evlija Çelebiut, në shekullin XVII.

Evlija Çelebiu, kur e vizitojë këtë qytet, për strukturën e popullatës së qytetit të Vushtrrisë shkruan se popullata nuk dinin të flasin gjuhët sllave, por ata flasin në gjuhën shqipe dhe turke.

Siç shihet Misko Camilovici, duhet të jetë nipi i Ali Agë Qamilit, por të dhënat e vërteta për këtë familje mund të zbulohen vetëm pas deklaratave të tij.

Nga literature serbe mësova se në fund të shekullit XIX, dy vëllezër shqiptar nga fshati Batair, rrethi i Mitrovicës, kishin kryer disa vjedhje dhe plaçkitje te disa familje në atë rajon. Kryesisht nëpër disa fshatra kishin vjedhur kafshë të ndryshme. Gjatë vjedhjeve ata edhe kishin krijuar shpesh herë edhe incidente me armë duke plagosur disa fshatar. Ali Agë Qamili, detyrohet që ti takojë këta hajdut dhe i detyron që ti kthejnë të gjitha kafshët e vjedhura te familjet e dëmtuara. Ky rast kishte ndodhur në vitin 1898, nga letrat që Stojan Novakovici ja kishte dërguar Tefik Pashës, rreth incidenteve gjatë kësaj periudhe në mes të myslimanëve dhe ortodoksëve në Kosovë. Nga këto letra kuptojmë se Stojan Novakoviqi, për çdo incident që ndodhte në mes të ortodoksëve dhe shqiptarëve mysliman, në trevat shqiptare brenda territorit të P. Osmane, ai e lajmëronte edhe Spiridon Gopçeviçin në Beograd.

Siç po shihet rasti paska ndodhur në vitin 1898, kur Ali Agë Qamili i paska detyruar hajdutët që ti kthejnë bagëtitë e vjedhura.

Ajo që më bënë kureshtar të di është sepse po në këtë vit lindë Atanasije Urosevici, dhe e ëma e tij Mara ishte nga familja bejlerë Qamili e Vushtrrisë. Atëherë lindë pyetja se a quhej Mara me këtë emër në vitin 1898, dhe a ishte Mara e krishterë apo myslimane? Gjithashtu është me interes të dihet se familja e Urosevicit, në vitin e lindjes së tij, a ishte e krishterë apo ishte myslimane? Këto dilema mund të hiqen vetëm nëse kane vullnet familjarët e Ali Agë Qamilit ta thonë të vërtetën, edhe pse tash janë serbizuar.

Bazuar në këto dëshmi të mbledhura në terren, si dhe nga literature në gjuhën serbe, mund të arrijmë në përfundim se familja e Atanasije Urosheviqit, ishte familje shqiptare katolike, autoktone nga fshati Tullarë, afër Medvegjës, e cila si e krishterë, për shkak të një ngatërrese u shpërngul në fshatin Rahavicë të komunës së Dardanës.

Gjyshi apo baba i Atanasije Urosheviqit, në gjysmën e parë të shekullit XIX, prej Rahavicës shpërngulet në qytetin e Gjilanit. Kjo familje integrohet mjaftë mirë në qytetin e Gjilanit, islamizohet dhe fillon të ushtrojë me sukses veprimtarinë tregtare e zejtare, për përpunimin dhe shitjen e zhgunave. Duke qenë familje më zë në qytetin e Gjilanit, kjo familje lidhë miqësi po ashtu me familjen e njohur të Ali Agë Qamilit, në qytetin e Vushtrrisë.

Atanasije Urosheviq, pasi u arsimua në shkollën serbe, nga pushteti i asaj kohe u detyrua, që kryesisht të merret me origjinën e familjeve të trevave shqiptare, të Anamoravës dhe rrafshit të Kosovës. “Studimet e tij kishin për qëllim që popullata

ortodokse serbe të përshkruhet si popullatë autoktone, në këto treva, ndërsa ajo katolike të përshkruhet se vërshuan nga malësia e Shqipërisë drejtë veriut në tokat serbe”.

Megjithatë prapë nga studimet e tij, prapë mundë të gjinden informata të rëndësishme për të hulumtuar të vërtetën e popullatës shqiptare në këto treva.

Mbetet e pa kuptueshme pse vetëm të dhënat e mbledhura prej tij në trevën e llapit mbetën të pa botuara deri më sot. Sigurisht se në shënimet e tij ka mjaftë shumë argument se në këtë rajon, deri në luftërat ballkanike, nuk jetonte asnjë familje serbe.

Me pushtimin e Kosovës gjatë luftërave ballkanike, të dy këto familje për ta ruajtur pasurinë e tyre, dhe që të mos shpërnguleshin në Turqi, u detyruan që të serbizohen. Raste të tilla të serbizimit të familjeve shqiptare në Kosovë, në këtë periudhë janë të shumta. Sipas dëshmimeve të terrenit, këto familje gjatë sundimit serbë ishin në vëzhgim të rreptë të pushtetit, dhe nuk guxonin ta përmendnin identitetin e tyre kombëtar as para fëmijëve të vet.

Aleksandër Lambert, një historian, dhe drejtor akademik i “School of International Training” në Gjenevë, është autor i disa librave dhe artikujve në fushën e politikave ndërkombëtare, relacioneve mes shteteve dhe popujve, të filozofisë politike, të politikës së sigurisë dhe lidhjeve civile-ushtarake.

Lambert që në rini, e ka vizituar Shqipërinë, dhe ka filluar të bëjë studime për çështjen shqiptare. Për ta njohur sa më mirë çështjen shqiptare ai ka hulumtuar dokumente të shumta për shqiptarët në Arkivin e Lidhjes së Kombeve Gjenevë.

Duke hulumtuar për shqiptarët, dhe personalitete të rëndësishme që dolën nga gjiri i këtij populli, Aleksandre Lambert shkruan se nuk është e rastësishme që shumë shqiptarë kanë shkëlqyer gjatë periudhave të ndryshme të historisë, duke drejtuar perandori dhe shtete, si dhe kanë lënë emrin e tyre në fusha të ndryshme të shkencave në disa vende të botës.

Lambert, në studimet e tij bënë një kritikë, ndaj shteteve më të fuqishme të botës, duke e përshkruar kontributin e madh që e dhanë shqiptarët për qytetërimin dhe civilizimin e njerëzimit.

Në të vërtetë pas mundjes së turqve në luftën ruso-turke, shtypi ndërkombëtar filloi punën për të injoruar shqiptarët duke i ndërruar emrin gadishullit të dikurshëm të Ilirisë të banuar që nga kohët parahistorike dhe deri në ditët e sotme nga fiset ilire (shqiptarët). Nga ndikimet e shumta të qarqeve dhe lëvizjeve të formuara në Evropë kundër shqiptarëve, Gadishullin Ilirik e pagëzuan me emrin e ri, Gadishulli i Ballkanit, nga vargu i maleve Ballkan që fillon prej Detit të Zi.

Shqiptarët dhe boshnjakët me origjinë ilire që e kishin, pranuar fenë islame, u injoruan nga pjesa më e madhe e diplomacisë konservatore evropiane. Evropianët i shihnin si rrezik për kulturën dhe qytetërimin perëndimor, andaj edhe filluan që ti quajnë me termin pexhoratif “turq” për t’i cilësuar si turq, edhe pse si popull më

kulturë të lashtë dhe gjuhë krejtësisht të ndryshme, shqiptarët asgjë nuk i lidhte me osmanët.

Evropa ka mbështetur dhe ka zmadhuar tokat e Greqisë, të Serbisë dhe të Malit të Zi, në kurriz të shqiptarëve. Asnjëra nga fuqitë e mëdha evropiane nuk e ka mbështetur çështjen shqiptare.

Me të drejtë Lambert thotë se shqiptarët kanë një histori që nuk e njohin as vetë. dhe në tre shekujt e fundit Evropa, anashkaloi duke mos i mbështetur të drejtat e tyre, por duke krijuar mundësinë e sllavizmit dhe greqizmit të popullatës autoktone shqiptare dhe vllahe.

Pra siç shihet nga fuqitë e mëdha të kohës, asimilimi dhe shkrirja në popuj tjerë të popullatës autoktone shqiptare dhe vllahe, ishte bërë platformë politike dhe ushtarake në Evropë.

Shqiptarët për të mbijetuar, në trojet e veta autoktone, duhet thelluar studimet për lashtësinë, identitetin dhe kulturën tradicionale, duke ofruar para opinionit ndërkombëtar argumente bindëse shkencore për autoktoninë dhe lidhjet e hershme kulturore dhe fqinjësore me popujt e lashtë tjera të Mesdheut.

Për tu realizuar kjo është e nevojshme një lëvizje kulturore mbarë kombëtare, e mbështetur në burime shkencore dhe e përkrahur nga qarqet politike e akademike shqiptare.

Sidomos studimet duhet shtuar për vllahët dhe bashkëjetesën e tyre me shqiptarët, që nga sundimi romak e deri në shekullin XX, kur nga ndikimet e politikës pansllaviste ruse, këto dy komunitete u keq përdorën nga politika, për ti shtyrë kah asimilimi dhe vrasja mes sojit të vetë.

Vet shtrirja e vllahëve nëpër trevat ilire, duke filluar në perëndim, që prej Sllovenisë së sotme, e deri në Detin Mesdhe edhe Detin Jonë, dëshmon për një popullatë ilire të romanizuar gjatë sundimit romak, e cila me kohë humbi disa tipare karakteristike tradicionale ilire, por që mbijetoi dhe u zhvillua, krahas popullatës tjetër ilire (shqiptare), e cila i mbijetoi romanizimit dhe tjetërsimit të plotë deri në ditët e sotme.

Se cila është lidhja e këtyre familjeve arbërore e vllahe me familjet dhe fiset shqiptare në trevat veriore të Shqipërisë, na tregon Aleksa Bogosavleviqi në librin e tij ‘O arnautima’ të botuar në qytetin e Nishit në vitin 1897.

Ja si e përshkruan afërsinë e shqiptarëve dhe vllahëve, Aleksa Bogosavleviqi, një vllah i serbizuar i cili në librin e tij “O Arnautima” duke thënë për shqiptarët shkruan: Si është ky popull, lexuesit do të lexojnë nga librat, por besimi im është, se shpesh gjithçka që na vjen nga Arnautët, ndodh vetëm sepse ne nuk bindemi fare, ose ajo që na ndan është një kodër e vogël, ata ishin fqinjët tanë më të afërt që nga kohërat e lashta. Sepse ata na i morën pas shpërnguljes fatkeqe të vitit 1690 vatrat tona të vjetra, Tek ata ka mjaftë gjak tonin. Ne jemi më shumë shqiptar i një fisi për nga gjaku, dhe vëllezër për nga

vuajtja, sidomos me Drenicas, Rugovas Lumbardhët, Shkodranët, Dibranët, Malësorët, Llapjanët e shumë të tjerë, të cilat ndahen në 9-10 fise. Ata janë kushërinjtë e serbëve të besimeve ortodokse dhe katolike, duke pretenduar prejardhje fisnore me anë të gjakut, zakonit, festave dhe fisit.

Какав је ово народ, видеће читаоци из књиге; али моје је уверење: да се често све зло, које нам долази од Арнаута, дешава само због тога, што их ми никако не познајемо, или врло мало, мада су нам они били најближи суседи из давнина. Јер нам они заузеше после несрећне сеобе од 1690 године старо огњиште наше. У њима има доста крви наше. Ми смо са многим Арнаутима род по крви, а браћа по патњи, нарочито са Дреничанима, Руговцима, Љумљанима, Шкодранима, Дебранцима, Малисорцима, Лабљанима и многим другима, који се деле на 9—10 фисова. Они се рођакају са Србима православне и католичке вере, тврдећи племенско сродство по крви, обичају, слави и племену.

Dëshmi se si e përshkruan afërsinë e shqiptarëve vllahët (tani të serbizuar), autori i librit "O Arnautima" Aleksa Bogosavleviqi, me origjinë vllahe.

Siç shihet te ky tekst i shkruar gjatë shekullit XIX, nga një vllah, kuptojmë se tërë Gadishulli Ilirik i veriut ishte i banuar me popullatë arbërore dhe vllahe. Po ashtu këtu vërehet çartë se serbët u formuan si etnitet dhe komb në këtë shekull duke përfshirë shqiptarët e asimiluar nga të gjitha trevat dhe fiset veriore të Gegërisë.

Pra formimi i shteteve sllave, në trevat veriore shqiptare ishte projekt rusë, i iniciuar gjatë shekujve XVIII e XIX, nga lëvizja pansllaviste që u themelua në Parisë, që e udhëhiqnin polakët dhe rusët, por që u përkrahën edhe nga francezët, prusët dhe gjermanët tjerë verior.

Sipas rrethanave politike dhe historike që kanë ndodhur në Gadishullin Ilirik pas pushtimit osman, e sidomos prej shekullit XVII, kur Rusia u bë faktor i rëndësishëm politik dhe ushtarak në trojet tona fillojë procesi i sllavizimit dhe greqizmit të popullatës arbërore dhe vllahe.

Nga këto të dhëna arrijmë në përfundim se: As komb dhe as etni Serbe nuk ka eksistuar në mesjetë! Serbia u krijua si entitet politik në shekullin e XIX, duke e asimiluar popullsinë shqiptare dhe vllahe.

Serbët e sotëm kurrë nuk kanë pasur shtet, as identitet etnik, para shekullit XIX – Servia emër rajoni në shërbim dhe jo emër etnie.

Gjatë shekullit XVIII, sipas projekteve pansllaviste në pjesën qendrore të gadishullit me qendër në Smederevë, së pari u krijua një grup politik ortodoksësh që e quanin veten serb, e të cilët kishin përkrahje të fortë nga Rusia dhe Patrikana e Stambollit. Nga kjo platformë politike duke e asimiluar popullatën arbërore dhe vllahe të besimit ortodoks dhe në dëm të trojeve shqiptare u formua kombi dhe shteti politik serb.